

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë prej gjyqtarëve: Ragip Namani kryetar, Biljana Rexhiq dhe Dalip Bega anëtarë, me bashkëpunëtorin profesionale Sebahate Hoti procesmbajtëse, duke vendosur sipas ankesës së të pandehurit Vidoje Tonic nga Lypjani, kundër aktvendimit të Gjykatës komunale për kundërvajtje në Prishtinë, Regj.I.nr.14836/2012, të dt. 24.09.2012, e në bazë të neneve 31, al.3 39 dhe 221 të Ligjit për kundërvajtjet, me datë, 20.03.2013, merr këtë;

AKTVENDIM

Ankesa është pjesërisht e **BAZUAR**.

✓ **NDRYSHOHET** aktvendimi i Gjykatës Komunale për Kundërvajtje në Prishtinë Regj.I.nr.14836/2012 i datës 24.09.2012. ashtu që ndaj të pandehurit Vidoje Tonic, për kundërvajtjen e njejtë në vështrim të nenit 10 të Ligjit mbi Kundërvajtjet i shqiptohet masa disiplinore QORTIM.

Nga një kopje të këtij aktvendimi duhet dorëzuar palëve.

A r s y e t i m

Gjykata komunale për kundërvajtje në Prishtinë, me aktvendimin Regj.I.nr.14836/2012 e datës 24.09.2012, të pandehurin Vidoje Tonic nga Lypjani, e ka shpallur përgjegjës sepse si zyrtar i lartë publik „Zëvendës Drejtor në Ministrinë e Administratës Publike në Prishtinë, nuk e ka bërë deklarin e rregullt vjetor të pasurisë, në Agjensin Kundër Korrupsionit brenda afatit ligjor 31.03. 2012 ., me ç, veprim ka bërë kundërvajtje nga neni 8 lidhur me nenin 5.1 dhe 6.2, e dënueshme sipas nenit 17 para. 1 pika l. të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar, për të cilën kundërvajtje, i shqiptoi gjobën në shumë prej 1.000€.(Njëmijëeuro). Me të njëjtin aktvendim i pandehuri është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 5 €.

Kundër këtij aktvendimi ankesë ka parashtruar i pandehuri Vidoje Tonic i cili ndër të tjera thekson; se është pensionuar prej datës 29.06.2012, se deklarimin e pasurisë e ka bërë me vonesë dhe e ka deklaruar me 23.05.2012, se në atë kohë ka qen me gjendje të përkeqësuar shëndetësore ndërsa prej datës 27.03.2012 e gjer me 03.04.2012 ka qen në pushim vjetor ,se nuk e ka ditur rëndësinë e deklarin të pasurisë sepse kërkesa për deklarim të pasurisë i është dërguar në gjuhë shqipe, se ka qen nën presion psikik për shkak të shkuarjes në pension ,andaj nga të lartë cekurat kërkon që të lirohet nga dënimi i shqiptuar sepse nuk ka prej nga ti siguroj të hollat për ta paguar dënimin pasi që tani është pensionuar.

Kolegji i kësaj Gjykate vlerësoi thëniet në ankesën e paraqitur, aktvendimin e goditur, deklaratën e të pandehurit Vidoje Tonic, deklaratën e dëshmitarit- Përfaqësuesit të AKK-së Enis Sadiku, si dhe shkresa tjera nga lënda, dhe konstatoi se ankesa e paraqitur e të pandehurit është pjesërisht e bazuar, vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin.

/...

03-2192/13/02
sej

2.

Kolegji konstaton se Gjykata e shkallës së parë, gjatë zhvillimit të procedurës nuk ka bërë shkelje të dispozitave të procedurës kundërvajtëse, dhe gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila i vihet në barrë si në dispozitiv të aktvendimit të shkallës së parë e kjo vërtetohet edhe nga deklarata e të pandehurit të dhënë në gjykatë të shkallës së parë se deklarimin e pasurisë nuk e ka bërë në afatin e caktuar ligjor, ndërsa janë të paqëndrueshme dhe të pazhuara theksimet e tij në gjykatë të shkallës së parë dhe në ankesë, se formulari për deklarimin e pasurisë nuk i është dorëzuar me kohë në gjuhën e tij amtare, ndërsa të kundërtën e dëshmon dëshmitari Enis Sadiku-përfaqësues i AKK-së i cili në gjykatë të shkallës së parë ka deklaruar, se formularët për deklarimin e pasurisë për zyrtarët e lartë nëpër të gjitha institucionet sipas rregullit të mbrendëshëm dërgohen në dy gjuhë, në gjuhë shqipe dhe serbe si në rastin konkret ku për mes zyrtares ndërlidhëse me AKK-në Bahrije Spanca i është dërguar me kohë në gjuhën serbe, andaj nga të lartcekurat si dhe shkresat tjera të lëndës, vërtetohet se i pandehuri ka kryer kundërvajtjen e cila me Kërkesë i vihet në barrë, e për të cilën mbanë përgjegjësi kundërvajtëse, dhe nuk ka bazë ligjore që të lirohet nga përgjegjësia.

Kolegji duke e vlerësuar aktvendimin e goditur në pjesën që ka të bëjë me gjobën e shqiptuar, nga gjykata e shkallës së parë, e duke i pasur për bazë rrethanat lehtësuese, se i pandehuri më datë 23.05.2012, e ka bërë deklarimin e rregullt të pasurisë në AKK, mandej se prej datës 10.06.2012 i është ndërprerë mardhënia e punës për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, se në kohën e kryerjes së kundërvajtjes kishte probleme shëndetësore, mandej gjendjen ekonomike të pandehurit, se më parë nuk ka qenë i dënuar dhe faktin se në të ardhmen nuk ka mundësi të përsëris kundërvajtje të tillë, andaj kolegji ia ndryshoi dënimin të pandehurit dhe në vend të gjobës në shumë prej 1.000€, konform nenit 10 të Ligjit mbi Kundërvajtjet, i shqiptoi QORTIM, duke konsideruar se edhe me këtë Masë disiplinore tek i pandehuri do të arrihet qëllimi i ndëshkimit.

Nga të lartcekurat e në vështrim të nenit 221 të LMK. u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
K.A.I.nr.321/2013, me datë, 20.03.2013

Procesmbajtësja,
Sebahate Hoti



KRYETARI I KOLEGJIT
Ragip Namani